



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit
dhe të Drejtave të Njeriut



Fushë-Arrëz, më 26.08.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 26, datë 08/08/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me Projekt vendimin **"Për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2025-2028"**

Analiza ligjore Bashkia Fushë-Arrëz, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj në fushën e diasporës dhe migracionit, ligjit "Për veteqeverisjen vendore, i ndryshuar Neni 29/1 dhe akteve nënligjore të tij, Strategjise Kombëtare për Diasporën Shqiptare, ligjit "Për te huajt", ligjit "Për shtetësinë", ligjin nr. 16/2018 "Për diasporën", i ndryshuar; hartoi grupi i punës (Programi Migrimi dhe diaspora), draftin e "Planit vendor të veprimit për migracionin dhe diasporën 2025-2028".

Situata aktuale e funksionit: Ky dokument është i një rëndësie të veçantë, duke marrë parasysh situatën aktuale, në të cilën nga njëra anë kemi migracionin gjithnjë në rritje drejt vendit tonë, si dhe migrantët e kthyer, si një komunitet me nevoja emergjente, të cilit duhet të kushtohet vëmendja e duhur për të arritur një ri-integrim të qëndrueshëm të tij, nga ana tjetër qëndron diaspora, e cila është një resurs i jashtëzakonshëm intelektual dhe ekonomik, si dhe potencial konkret për zhvillimin e vendit. Diaspora e Fushë-Arrëzit është një mundësi e madhe për zhvillimin e vendlindjes. Ky Plan veprimi synon të mbështesë organizimin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit, në mënyrë që të përmirësohet kapaciteti i Diasporës. Qëllimi është që ajo të mund të luajë rolin e një partneri të rëndësishëm strategjik për të ardhmen e vendlindjes. E gjithë kjo do të

realizohet me një proces rivlerësimi të marrëdhënies me Diasporën si një faktor, i cili do të ushtrojë ndikimin e vet në qytetin e origjinës dhe anasjelltas.

Me miratimin e këtij plani synohet gjithashtu incentivimi i investimeve nga diaspora në komunitetet e tyre të prejardhjes, si dhe organizatave ndërkombëtare, nëpërmjet implementimit të projekteve të perbashkëta, me qëllim zhvillimin social-ekonomik të qytetit. "Plani vendor i veprimit për migracionin dhe diasporën 2025-2028" është një dokument i rëndësishëm, i cili pasqyron detajimin e funksioneve bazë të sektorëve të ndryshëm të bashkisë, për permbushjen e detyrave të saj funksionale, duke e shëndrruar bashkinë në një portë të hapur për angazhimin dhe përfshirjen e diasporës së Fushë-Arrëzit në jetën ekonomike dhe socialkulturore të qytetit, si dhe një suport dhe ndihmë konkrete për migrantët e kthyer.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Çështjeve Sociale ka relatuar përpara komisionit për Projekt Vendimin.

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjimore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtoria e Çështjeve Sociale për zbatimin e projektit.

Impakti social / grupet që preken: Impakton jetën të gjitha të gjithë banoret e Bashkisë dhe në veçanti banoret e Bashkisë që jetojnë në emigracion.

A është objekt i konsultimit publik: Është objekt konsultimi publik dhe konsultimi me publikun është mbajtur me datë 25 Gusht 2025.

Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjimore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut, i mbledhur me datën 26/08/2025, shqyrtoi projekt vendimin "Për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2025-2028" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,


VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në Relacionin e mbledhjes së Komisionit

Franc Doda
(emri, mbiemri, firma)



Kryetar i Komisionit

Pavlin Qafa
(emri, mbiemri, firma)



Sekretar i Komisionit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit

dhe të Drejtave të Njeriut

Nr. 2557 pro

Fushë-Arrëz, më 26.07.2025



PËR : KËSHILLIN E BASHKISË

FUSHË-ARRËZ

Lënda: Relacion mbi Projektvendimin për Planin Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2025-2028 për Bashkinë Fushë-Arrëz, që do t'i paraqitet Këshillit të Bashkisë për shqyrtim në mbledhjen e tij të datës 27.08.2025.

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Per vetëqerisjen vendore", i ndryshuar; Rregullores për Funkcionimin e Këshillit të Bashkisë, Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut në mbledhjen e datës 26.08.2025 me pjesëmarrjen e anëtareve: Franc Doda, Pavlin Qafa dhe Tereze Dema, mori në shqyrtim projektvendimin për miratimin e Planit të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2025-2028 për Bashkinë Fushë-Arrëz, paraqitur nga Sektori i Migracionit dhe Diaspores.

Elis Miria, prezantues i projektit thotë se: Bashkia Fushë-Arrëz, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj në fushën e diasporës dhe migracionit, ligjit "Për veteqeverisjen vendore, i ndryshuar Neni 29/1 dhe akteve nënligjorë të tij, Strategjise Kombëtare për Diasporën Shqiptare, ligjit "Për te huajt", ligjit "Për shtetësinë", ligjin nr. 16/2018 "Për diasporën" i ndryshuar, grupi i punës hartoi draftin e "Planit vendor të veprimit për migracionin dhe diasporën 2025-2028".

Ky dokument është i një rëndësie të veçantë, duke marrë parasysh situatën aktuale, në të cilën nga njëra anë kemi migracionin gjithnjë në rritje drejt vendit tonë, si dhe migrantët e kthyer, si një komunitet me nevoja emergjente, të cilit duhet të kushtohet vëmendja e duhur për të arritur një ri-integrim të qëndrueshëm të tij, nga ana tjetër qëndron diaspora, e cila është një resurs i jashtëzakonshëm intelektual dhe ekonomik, si dhe potencial konkret për zhvillimin e vendit.

Diaspora e Fushë-Arrëzit është një mundësi e madhe për zhvillimin e vendlindjes. Ky Plan veprimi synon të mbështesë organizimin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit, në mënyrë që të përmirësohet kapaciteti i Diasporës.

Qëllimi është që ajo të mund të luajë rolin e një partneri të rëndësishëm strategjik për të ardhmen e vendlindjes. E gjithë kjo do të realizohet me një proces rivlerësimi të marrëdhënies me Diasporën si një faktor, i cili do të ushtrojë ndikimin e vet në qytetin e origjinës dhe anasjelltas.

Sa më sipër "Plani vendor i veprimit për migracionin dhe diasporën 2025-2028", përbën një plan masash konkrete, të lidhura drejtpërdrejtë me fushën e migracionit dhe diasporës, të cilat garantojnë përmbushjen e projekteve prioritare për integrimin e tyre dhe përfshirjen në jetën sociale dhe ekonomike të Bashkisë Fushë-Arrëz.

Me miratimin e këtij plani synohet gjithashtu incentivimi i investimeve nga diaspora në komunitetet e tyre të prejardhjes, si dhe organizatave ndërkombëtare, nëpërmjet implementimit të projekteve të përbashkëta, me qëllim zhvillimin social-ekonomik të qytetit.

"Plani vendor i veprimit për migracionin dhe diasporën 2025-2028" është një dokument i rëndësishëm, i cili pasqyron detajimin e funksioneve bazë të sektorëve të ndryshëm të bashkisë, për përmbushjen e detyrave të saj funksionale, duke e shndërruar bashkinë në një portë të hapur për angazhimin dhe përfshirjen e diasporës së Fushë-Arrëzit në jetën ekonomike dhe social-kulturore të qytetit, si dhe një suport dhe ndihmë konkrete për migrantët e kthyer.

Franc Doda anëtar i komisionit, thekson se ky plan duhet të zbatohet.

Pa diskutime të tjera, anëtarët e komisionit me shumicë votash, ranë dakort me projektin e paraqitur duke e dërguar atë për miratim në mbledhjen e datës 27.08.2025 të Këshillit Bashkiak, duke kërkuar edhe mendime dhe propozime të tjera të këshilltarëve të pranishëm.

Duke kërkuar bashkepunimin tuaj!

PER KOMISIONIN

Franc Doda



Pavlin Qafa

